

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**



**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE**

Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së dytë - II-të, të rregullt të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 24.02.2020, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Sabri Rexhepi, Ali Zogjani, Durim Hajra, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Mensur Grajqevci, Hysni Hasani dhe Suhat Ademi.

Mungon: Ljubisa Qirkoviq.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Abdullah Prebreza - Drejtor i Planifikimit Urban, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave e Buxhetit dhe Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik.

Të tjerë: Ismail Baftiari - Përfaqësues i Kompanisë 'INSI', Flamur Kuqi - Përfaqësues i Kompanisë 'INSI' dhe Adnan Bullatovci - Zyrtar i Lartë për Mjedis, përfaqësuesit e OSBE-së, dhe përfaqësuesit e Shoqërisë Civile.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i propozimit për shpalljen e lokalitetit 'Forysthia Europae' në Golesh si monument i mbrojtur i natyrës në fshatin Harilaç.
2. Propozim për vazhdimin e taksave të vitit 2019, edhe në vitin 2020 lidhur me taksat administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit, lejeve të rrënimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.
3. Propozim për marrjen e vendimit për harmonizimin e dokumentit të Planifikimit Hapësinor me gjendjen në teren dhe fillimin e procedurave për harmonizimin e Planit Zhvillimor të Komunës.
4. Propozim për shqyrtimin e Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2020-2028.
5. Shqyrtimi i kërkesës për shfuqizimin e vendimit Nr. 151, të datës 30.07.2019 sipas kërkesës 020-860/6, të datës 16.10.2019.
6. Propozim për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetjake për vitin 2019.
7. Propozim për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetjake të vitit 2019, për shpenzim në vitin 2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe hapi diskutimin.

Durim Hajra: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Pyes pse pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare' nuk është pjesë e rendit të ditës?.

Migjen Kolshi: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Pyes pse pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare' nuk është pjesë e rendit të ditës dhe pika për formimin e Grupit Punues për hartimin e 'Projekt-Rregullores për organizimin e vendbanimeve, fshatrave dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

Driton Ademi: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Caktimi i pikave të rendit të ditës duhet të bëhet sipas planit të punës, sot mungojnë pikat e rendit të ditës: 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', Propozimi për formimin e Grupit Punues për hartimin e 'Projekt-Rregullores për organizimin e vendbanimeve, fshatrave dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', mirëpo meqë i kemi disa pika të rëndësishme për 'planifikimin hapësinorë', pajtohemi që rendi i ditës është specifikë dhe mund të arsyetohet.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës sqaroi se arsyeja e vetme është 'Propozimi për shqyrtimin dhe miratimin e Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës'. Pas sqarimeve e qiti në votim për aprovim rendin e ditës për këtë mbledhje.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', dy 'kundër' dhe katër abstenime, gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Shqyrtimi i propozimit për shpalljen e lokalitetit 'Forysthia Europae' në Golesh monument i mbrojtur i natyrës në fshatin Harilaç.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shpalljen e lokalitetit 'Forysthia Europae' në Golesh, monument i mbrojtur i natyrës në fshatin Harilaç', ftoi z. Adnan Bullatovci që të na jap sqarime.

Adnan Bullatovci - Zyrtar i Lartë për Mjedis: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, Instituti Kombëtar për Mbrojtjen e Natyrës në bashkëpunim me Komunën e Fushë-Kosovës, e kanë vlerësuar këtë zonë si vlerë të mbrojtur të natyrës. Lokalitetit i Boshtres, 'Forysthia Europae' në zonën e maleve të Goleshit do të jetë zonë nën mbrojtje natyrore. Është një zonë në kufijtë me komunat e Lipjanit dhe Drenasit, por pjesa më e madhe është në territorin e komunës tonë. Për këtë qëllim ka punuar Grupi Punues i përbashkët, i përbërë edhe nga profesorë të Universitetit të Prishtinës nga departamenti i biologjisë në mesin e tyre edhe profesori z. Elez Krasniqi, përfaqësuesit e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe përfaqësuesit e komunës. Baza ligjore për ta shpallur një zonë monument të natyrës është në dispozitat e nenit 14, të Ligjit për mbrojtjen e natyrës, ku sqarohen dhe përmenden rastet kur një zonë e caktuar mund të shpallet monument i mbrojtur i natyrës, meqë përmban karakteristika të rralla të botës bimë dhe paraqet një objektiv të botanikës që duhet të hulumtohet, të mbrohet eko-sistemi në natyrë. Zona konkretisht gjendet në vargmalet e vjetra të Goleshit me sipërfaqe të përgjithshme prej 87.86 ha, pjesa më e madhe në territorin tonë është prej 52ha. Boshtira është një bimë drunore e rrallë që rritet deri në tre metra lartësi dhe 15 milimetra gjerësi, riprodhohet me anë të farës në majin e katër dhe të pestë të vitit, por kulmin e saj të zhvillimit e arrin në muajin e tetë dhe nëntë

të vitit. Është një bimë endemike e gjetur në Shqipëri dhe Kosovë, e zbuluar nga z. Balldes në vitin 1987. Si bimë e rrallë gjendet në rrethin e Pejës, rrethin e Gjakovës, fshatin Bubavec të Malishevës, ndërsa te ne gjendet në fshatin Harilaç. Mbrojtja e saj hyn në shkallën e tretë të mbrojtjes së zonave të caktuara, shënohen kufijtë e saj, aty ndalohen ndërtimet dhe hedhja e mbeturinave.

Pasi që diskutime dhe sqarime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për shpalljen e lokalitetit 'Forysthia Europae' në zonën e Goleshit monument të mbrojtur të natyrës në Zonën Kadastrale të fshatit Harilaç'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për shpalljen e lokalitetit 'Forysthia Europae' në zonën e Goleshit monument të mbrojtur të natyrës në Zonën Kadastrale të fshatit Harilaç' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e 'Propozimit për shpalljen e lokalitetit 'Forysthia Europae' në zonën e Goleshit monument të mbrojtur të natyrës në Zonën Kadastrale të fshatit Harilaç'.

Pika e dytë (2) - Propozim për vazhdimin e taksave të vitit 2019 edhe në vitin 2020 lidhur me taksat administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit, lejeve të rrënimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për vazhdimin e taksave të vitit 2019 edhe në vitin 2020, ku taksat administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit, lejeve të rrënimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës', janë pa ndryshime, ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban që të na jap sqarime.

Drejtori për Planifikim Urban: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Ju para vetës e keni propozimin për vazhdimin e taksave të ndërtimit të vitit 2019 edhe për vitin 2020, propozimet tona ne i kemi dërguar në muajin nëntor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me taksat administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit, lejeve të rrënimit dhe tarifës për rregullimin e densitetit në infrastrukturë, që të mos vonohemi, ndryshime nuk ka. Ne kemi filluar me zbatimin e tyre vetëm pas konfirmimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në muajin gusht të vitit 2019, ato duhet të zbatohen së paku gjahtë muaj. Në material ju i keni sqarimet, taksat e ndërtimit për kategorinë e parë, për banimin individual janë 1.51€, për kategorinë e dytë ky hyn ndërtimet e larta kolektive është 1.96€, për një metër katërorë.

Pasi që diskutime dhe sqarime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për vazhdimin e taksave të ndërtimit të vitit 2019 edhe në vitin 2020, për taksat administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit, lejeve të rrënimit dhe tarifës për rregullimin e densitetit në infrastrukturë'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për vazhdimin e taksave të ndërtimit të vitit 2019 edhe në vitin 2020, për taksat administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit, lejeve të rrënimit dhe tarifës për rregullimin e densitetit në infrastrukturë' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e 'Propozimit për vazhdimin e taksave të ndërtimit të vitit 2019 edhe në vitin 2020, për taksat administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit, lejeve të rrënitit dhe tarifës për rregullimin e densitetit në infrastrukturë'.

Pika e tretë (3) - Propozim për marrjen e vendimit për harmonizimin e dokumentit të Planifikimit Hapësinor me gjendjen në teren dhe fillimin e procedurave për harmonizimin e Planit Zhvillimor të Komunës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për marrjen e vendimit për harmonizimin e dokumentit të Planifikimit Hapësinor me gjendjen në teren dhe fillimin e procedurave për harmonizimin e Planit Zhvillimor të Komunës', për periudhën tetë vjeçare që ndërlidhet edhe me vlefshmërinë e Hartës Zonale të Komunës, ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban që të na jap sqarime.

Drejtori për Planifikim Urban: Plani Zhvillimor Komunal duhet të harmonizohet me gjendjen në teren për arsye të ndryshimit të ligjit, gjendjes në teren ky hyn edhe ndërtimi i autostradës. Ne do të fillojmë procedurat për harmonizimin e Planit Zhvillimor Komunal 2013/2023, me kohëzgjatjen e Hartës Zonale të Komunës, duke u mbështetur në bazën ligjore që e kemi në propozimin për këtë dokument strategjik të planifikimit hapësinor.

Durim Hajra: Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal e ka bazën në Hartën Zonale të Komunës, duke e harmonizuar atë me gjendjen në teren, çka do të thotë kjo ndryshimi i gjendjes në teren si rekomandim nga ekspertët e Hartës Zonale të Komunës në fund, këtu e kemi një ngutje në hapa. Në fillim është dashur të hartohet Plani Zhvillimor Komunal, pastaj Harta Zonale e Komunës, duke u mbështetur në të, andaj mbështetur në këto fakte, ne pak dyshojmë se këtu kemi të bëjmë me një themel jo të fortë që e karakterizon zhvillimin e komunës tonë në periudhën e ardhshme.

Drejtori për Planifikim Urban: Propozimi për hartimin e Hartës Zonale të Komunës është obligim ligjor i komunës, me përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka punuar një ekip i ekspertëve, ku është diskutuar edhe për harmonizimin e Planit Zhvillimor Komunal, kjo është baza ligjore pse është vepruar kështu. Ne e kemi në funksion Planin Zhvillimor Komunal 2013/2023, duhet ta lexoni mirë bazën ligjore, ka patur ndryshime në teren, andaj kemi vepruar në këtë mënyrë.

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Propozimi është arsyetuar pak edhe nga kërkesa e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ky kërkohet që komuna ta bënë harmonizimin e Planit Zhvillimor Komunal me gjendjen në teren, këtë do ta shpjegojnë edhe ekspertët që e kanë hartuar Hartën Zonale të Komunës. Pyetja ime, për Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban, pse ka ardhur deri te kjo gjendje në teren, cilët janë shkaktarët, planet aktual zhvillimore: Plani Zhvillimor Komunal, Plani Zhvillimor Urban, sot vjen të miratohet Harta Zonale e Komunës, duhet të tregohen shkeljet ligjore, në mënyrë që ne të bindemi për të votuar për miratimin e Hartës Zonale të Komunës. Duhet të tregohen shkaktarët a janë ata ekonomik, biznesi individual, apo komuna ka mbetur prapa përcjelljes së proceseve zhvillimore, nuk ka aprovuar plane, pse po ndodh kjo?.

Drejtori për Planifikim Urban: Bartëse e hartimit të planeve zhvillimore është komuna, është përgjegjësi e Kryetarit të Komunës. Ne Planit Zhvillimor Komunal 2013/2023, e kemi në fuqi, planet zhvillimore urbane i rregullojnë lagjet e caktuara, konform vendimeve tona, ekspertët kanë

punuar Hartën Zonale të Komunës, ata kanë ardhur në përfundim se Plani Zhvillimor Komunal duhet të plotësohet, sepse edhe Qeveria e Kosovës ka ndërtuar autostradën në territorin e komunës tonë, është ndërtuar edhe rrjeti i largëprçuesve, ne planin e kemi funksional deri në muajin mars të vitit 2023, kjo është arsyeja që Plani Zhvillimor Komunal duhet të harmonizohet si dokument i planifikimit strategjik, në përputhje me Hartën Zonale të Komunës.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Planifikimi hapësinor i Komunës së Fushë-Kosovës, duhet të jetë i harmonizuar me Planifikimin Hapësinor të Kosovës dhe formalisht brenda rregullave të lojës për fushën e rregullimit hapësinor. Harta Zonale e Komunës duhet të jetë në mënyrë reciproke e harmonizuar me planin zhvillimor komunal për territorin e komunës, çdo plan tjetër është i tepërt. Pa u sqaruar saktë procesi i harmonizimit të planit, ne nuk kemi si ta mbështesim këtë proces, ky është qëndrimi ynë për këtë punë.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Shumica e çështjeve u diskutuan dhe sqaruan nga parafolësit e mi Drejtori i Planifikimit Urban, z. Durim Hajra, por Harta Zonale e Komunës është përgatitur tani, unë e kam lexuar edhe rekomandimin e dhënë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, plani zhvillimor komunal si i tillë nuk është refuzuar, por e kemi një kërkesë për harmonizimin e tij, ne duhet të punojmë në këtë proces, duke u mbështetur në rekomandimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtu i kemi dy anë të medaljes, së pari nga njëra anë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është vonuar në raport me proceset në Komunën e Fushë-Kosovës. Komuna jonë ka punuar mirë, ka filluar me përgatitjen e Hartës Zonale të Komunës, ne nuk e dimë saktë ndoshta edhe politikisht Ministria është vonu në raport me Fushë-Kosovën. Nëse Harta Zonale e Komunës është punuar në raport me hartën nacionale, kjo punë është e mirë, çka ka punuar Drejtoria e Planifikimit Urban, përgjegjës është Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës. Ne si Kuvend i marrim vendimet Ekzekutivi i Komunës, respektivisht Drejtoria e Planifikimit Urban i zbaton. Planit Zhvillimor Komunal 2013/2023 i ka kalur koha, ka ndryshuar në teren gjendja faktike, ka ndërtime të objekteve pa leje, që do t'i nënshtrohen procesit të legalizimit, por si do të veprohet me objektet ndërtimore që janë jashtë rregullave për ndërtim të parapara me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2017 për normat minimale teknike të ndërtimit.

Drejtori për Planifikim Urban: Baza ligjore për harmonizimin e Planit Zhvillimor Komunal është në shkresën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, te propozimi për miratimin e Hartës Zonale të Komunës. Ndërtimet pa leje do të trajtohen sipas ligjit për legalizime, ndërtimet deri në muajin gusht të vitit 2018, ato që i plotësojnë kushtet dhe nuk bien ndesh me planet 5zhvillimore urbane do të legalizohen, nuk legalizohen ndërtimet në pronë publike, ato mbeshin në listën e pritjes. Ne i kemi në planin aktual zhvillimor komunal edhe tre vite deri në vitin 2023, por duhet të veprojmë për arsye se plani zhvillimor komunal duhet të harmonizohet me gjendjen në teren, e cila ka ndryshuar.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani e kemi një propozim interesantë, një prezantim me rëndësi për komunën tonë. Qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës duhet të adresohen problemet në mënyrë taksative dhe të drejtë, e jo në formë të kombinuar. Ndërtimet në komunën tonë janë problematike tani, para tregimit për gjendjen faktike, hapësirat publike janë zënë, dikun ndërtimet janë P+4, dikun P+6 dhe dikun P+8, sot Fushë-Kosova është në këtë gjendje hapësinore, ne nuk guxojmë t'i mbyllim sytë, banorët tjerë diskriminohen me këtë rregulla në

krahasim me ndërtimet deri tani, vendimet duhet të krijojnë kushte të barabarta për të gjithë. Planet zonale nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të marrin parasysh gjendjen reale në teren. Janë lejuar ndërtime deri në tetë etazhe duke e zënë hapësirën nga kompanitë private në dëm të interes publik, gjendja në teren duhet të rregullohet, por jo duke shkelur ligjet dhe duke krijuar kushte të pabarabarta për ndërtuesit. Kjo gjendje që na adresohet neve sot, është çështje e organeve përgjegjëse, nga Drejtoria e Urbanizmit është thënë këtu në Kuvendin e Komunës se ne jemi qind për qind në përputhje me ligjin, atëherë kjo është detyrë e tjetërkujt. Drejtoria e Inspektoratit ka theksuar se ne u kemi dërguar letrat ndërtuesve, por ndërtesat janë ndërtuar gjithë andej, puna e urbanizmit dhe inspektoratit janë të ndërlidhura, duhet të bashkohen të gjitha forcat brenda komunës për të krijuar rregull. Një çështje e ndërtimit ka qenë në gjykatë, ku Drejtori i Inspektoratit z. Jakup Dumani është liruar, ndërsa është dënuar pronari i ndërtimit, komuna para qytetarëve duhet të paraqet plane për zona dhe makroplane që garantojnë zhvillim në kuadër të ligjeve në fuqi. Most ë lejohen njerëzit të ndërtojnë, kur ato ndërtime duhet të rrënohen, këtu punë nuk duhet të përrëriten, nuk duhet të lihet kjo punë në mëshirën e privatit, unë do të jem pro vendimit për fillimin e procedurave për harmonizimin e Planit Zhvillimor Komunal në interesi e zhvillimit të përgjithshëm për qytetarët e komunës tonë.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ‘Propozimin për marrjen e vendimit për hartimin e dokumentit të Planifikimit Hapësinor, Planit Zhvillimor Komunal me gjendjen në teren, si dhe fillimin e procedurave për harmonizimin e Planit Zhvillimor të Komunës’.

U votua me: tetë mbëdhjetë vota ‘për’, asnjë ‘kundër’ dhe gjashtë abstenime, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi ‘Propozimin për marrjen e vendimit për hartimin e dokumentit të Planifikimit Hapësinor, Planit Zhvillimor Komunal me gjendjen në teren, si dhe fillimin e procedurave për harmonizimin e Planit Zhvillimor të Komunës’ dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e ‘Propozimit për marrjen e vendimit për harmonizimin e dokumentit të Planifikimit Hapësinor me gjendjen në teren dhe fillimin e procedurave për harmonizimin e Planit Zhvillimor të Komunës’.

Pika e katërt (4) - Propozim për shqyrtimin e Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2020-2028.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim ‘Propozimin për miratimin e Projekt-Hartën Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028’, që do t’i jep kahje zhvillimit të komunës tonë në periudhën e ardhshme tetë vjeçare, ftoi përfaqësuesin e Kompanisë INSI, që e kanë punuar dhe përgatitur projektin që të na jap sqarime dhe shpjegime tjera.

Ismaili Baftiari - përfaqësues i Kompanisë INSI: Unë i përshëndes të gjithë të pranishmit në mbledhje, e nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës ju falënderoi juve dhe Ekzekutivin e Komunës për mundësimin e këtij prezantim. Hartimi dhe përgatitja e këtij dokumenti të planifikimit hapësinorë për komunën tuaj, është bërë duke u mbështetur në reformat ligjore që kanë ndodhur në ligje dhe udhëzime administrative për planifikimin hapësinorë, element tjetër

përmbajtësor me rëndësi është kyqja e qytetarëve të interesuar në procesin e hartimit të dokumentit përmes pjesëmarrjes publike, ku janë zhvilluar takime me komunën, në këtë hartim janë pjesëmarrës shumë aktorë, dokumenti ka patur informimin e duhur përmes ueb-faqës së komunës dhe në gazeta ditore. Pjesëmarrësit në diskutime janë informuar mirë për procesin, në fillim e kemi bërë dixhitalizimin e gjendjes ekzistuese, kemi marrë shumë informata: për gjendjen teknike të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, njësitë e banimit, tani në bazë të hartës, sa janë ato reale, pas grumbullimit të materialit dhe incizimit të gjendjes, e kemi krijuar platformën dixhitale, të ardhmen për leje dhe hapësira tjera, platformën e zonave të caktuara. Ligjet janë ndërruar, kemi patur kufizime të mëdha, për t'i ruajtur distancat anësore, të zhvillimit pa kontroll nga e kaluara, kemi bërë klasifikimin e vendbanimeve formale. Në këtë format të përgatitjes së hartës kanë qenë nën pesëdhjetë mijë banorë, më saktë sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 kanë qenë tri dhjetë e katër mijë banorë, gjendja në teren ka qenë krejt ndryshe, ne i kemi marrë për bazë orët e amvisërive dhe bizneseve, orët e ujit dhe e kemi pruarë Komunën e Fushë-Kosovës mbi pesë dhjetë mijë banorë, që të hyn në rregullat për hartimin e Hartës Zonale të Komunës prej pesë dhjetë mijë deri në një qind mijë banorë. Mbështetur në kode dhe koeficienta tani Komuna e Fushë-Kosovës hyn në rendin e dytë të komunave të mëdha të Kosovës. Struktura zhvillimore urbane në Komunën e Fushë-Kosovës e ka njohur një zhvillim të shpejtë, për arsye të afërsisë me kryeqytetin Prishtinën. Tani disa shpjegime shtesë në aspektin teknik përmes sllajdeve për fusha të caktuara do t'i jap profesori nga Tirana z. Flamur Kuqi.

Flamur Kuqi - profesor nga Tirana përfaqësues i Kompanisë INSI: Përsëritës të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Kuadri urbanistik dhe rregullativë përfshinë rregulla të reja, fakte të kuadrit të ri ligjor. Ka diferenca ligjore, udhëzime administrative të reja, si është udhëzimi administrative për normat teknike të ndërtimit, ku hyn edhe tipologjia dhe dendësia e popullsisë urbane, rurale e prezantuar në Hartën Zonale të Komunës, me Planin Zhvillimor Komunal që i japin një qëllim territorit të komunës me një definim përkatës për zhvillim. Formalisht, ne e kemi marrë si të mirëqenë në bazë të fakteve që u përmenden, kriterin mbi pesë dhjetë mijë banorë, konceptualisht territorin e kemi ndarë në sub-urbane, rurale dhe urbane qendrën, pjesën kryesore të qytetit deri në një qind mijë banorë. Projektionet, nevojat dhe klasifikimet, janë bërë duke e strukturuar pjesën e qytetit në lagje, komplekse të banimit dhe blloqe të banimit. Me Hartën Zonale të Komunës secili bllok ka risi tjera, aty hyn kushtet e ndërtimit, detyrimet që bartë komuna për nevoja publike, normat e përcaktojnë këtë. Një bllok i banimit sa ka nevojë për frymarrje sipas standardeve të ndërtimit, gjelbërim, hapësirë për shkollë dhe sport dhe aspektet tjera të territorit për rreth tij. Me hartën përcaktohet zona për ndërtim dhe hapësira publike. Zbatimi i hartës parasheh, planin e hollësishëm, njerëzit, pronat, parcializimin e tyre, lokacionin e sipërfaqeve publike. Këtu e re është kalimi i largëpërçuesve të tensionit të lartë të rrymës në disa vende, por me planet e hollësishme rregullative do të mbrohen interesat e publikut. Qartë këtu emërues i përbashkët unikë për Komunën e Fushë-Kosovës, është ruajtja e zonave dhe hapësirave rekreative, ndërsa në komunat tjera emërues mund të jetë diçka tjetër, por e rëndësishme është se Harta Zonale e Komunës së Fushë-Kosovës, është në harmoni me Hartën Zonale të Kosovës.

Ismail Baftiari - përfaqësues i Kompanisë INSI: Harta Zonale e Fushë-Kosovës ka qenë një vit në shqyrtim, është e plotësisht e harmonizuar me Planin Hapësinor të Kosovës 2010/2020+, kjo meqë ne jemi bazuar edhe në Planin Zhvillimor Komunal 2013/2023, unë nuk dua të hy tani në cilësinë e dokumentit, por ka patur edhe ndërhyrje tjera të pa planifikuara gjatë viteve edhe nga

niveli qendror, si është autoudha, hekurudha me Prishtinën, largëpërçuesit, reforma ligjore, kjo e fundit neve n aka ndihmuar shumë që ta përgatitim mirë këtë hartë zonale. Harta Zonale mbulon një periudhë prej tetë viteve, pas katër viteve nëse arrihen objektivat ka mundësi të ndryshohet, ajo mund të ndryshohet edhe në pjesë të caktuara, është edhe obligim ligjor rishikimi i dokumentit hapësinorë. Në një zonë të caktuar, dy ngastra kadastrale mund të kenë destinim të njëjtë, për kushte dhe nivel zone, edhe udhëzimi administrative ka përmbajtjen e kërkuar, arsytet janë mjedisi social aktual dhe elementet tjera, puna të gjitha, zhvillimi i përgjithshëm ka kaluar shpejtë, duhet të jemi në plotëni me kërkesat ligjore, pastaj zona mbishtresore, pjesa hartografike, destinimi e caktojnë zhvillimin. Pjesë e dokumentit janë edhe tabelat, ç'ka lejohet, ç'ka nuk lejohet, institucionet, kushtet e ndërtimit, zonat mbishtresore, pastaj pjesa nëntokësore, mbindërtimet, kushtet për ndërtime të përkohshme, pastaj Aeroporti, zonat, vendet e fluturimit, identifikimi zonës për funksionimin e Aeroportit. Këto fakte në disa raste kanë qenë lehtësi, por ka patur edhe kufizime, ky hyn normat, standardet, legjislacioni, tri direktivat e Bashkimit Evropian, të pa njohura për neve dhe për komunën. Shumë gjëra për t'i identifikuar më lehtë, ju i keni pjesën hartografike të përbërë nga tetëmbëdhjetë sllajde, duke filluar nga vendbanimet joformale dhe të dhëna tjera deri në nivelin e bllokut. Dokumenti në fjalë i ka edhe kufizimet e veta, që rrjedhin nga legjislacioni i ri, në këtë punë neve na ka përkrahur edhe USAID-i amerikan. Ne mendojmë dhe vlerësojmë se Harta Zonale e Komunës së Fushë-Kosovës, si dokument i planifikimit hapësinorë mbron interesat e komunës, qytetarëve dhe është e hapur për zhvillimin e përgjithshëm.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E falënderojmë përfaqësuesin e Kompanisë INSI për shpjegimet e dhëna. Hap diskutimin.

Mehdi Lahu: Përshëndes përfaqësuesin e Kompanisë për sqarimet e dhëna, por unë e kam një shqetësim tjetër lidhur me harmonizimin e Planit Zhvillimor Komunal me gjendjen në teren, ka gabime nuk specifikohet qartë periudha përcjellëse e dokumentit, profesionalisht ky plan është dokumenti më i rëndësishëm i komunës që cakton kahjet e zhvillimit të përgjithshëm. Unë propozoi që dokumentet e rëndësishme strategjike siç është: Harta Zonale e Komunës, të votohen me votat e dy të tretave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, kjo të definohet për të ardhmen, sepse baza ligjore ekziston dhe e mundëson këtë çështje.

Remzi Shala: Unë e përgëzoj Komunën e Fushë-Kosovës, respektivisht Drejtorinë e Planifikimit Urban për hartimin e dokumentit të Projekt-Hartës Zonale të Komunës që cakton zhvillimin e komunës, kjo paraqet një orientim shtesë për Komunën e Fushë-Kosovës, ne i dëgjuam sqarimet profesionale nga përfaqësuesit e Kompanisë 'INSI' të cilët theksuan se ky dokument strategjik për planifikimin hapësinorë e paraqet realitetin në teren.

Doruntina Jashari: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë pyes, sa është menduar për banorët e lagjes së Nakaradës të cilët gjenden në mes të hapësirës për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe komerciale, aty është një deponi e metaleve në ambientin e hapur, ku përpunohen materie të dëmshme në afërsi të vendbanimit. Si trajtohet kjo zonë me Hartën Zonale të Komunës?.

Durim Hajra: Ne jemi laik në këtë fushë, pyes si do të veprohet me zonat ndërrurbane, sepse Fushë-Kosova është zgjeruar jo vetëm në qendër, por edhe në disa zona periferike?. Pyes cilat janë mundësitë për lirim të hapësirave në qytetin tonë?.

Ali Ismaili: Fillimisht dua të konstatoj se është bërë një punë e madhe, pjesën profesionale të punës e ka kryerë Kompania 'INSI', por bartëse e procesit është komuna. Unë me profesion jam teologë, më intereson të dijë sa janë marrë parasysh aktiviteti i Aeroportit Ndërkombëtar 'Adem

Jashari', aktiviteti i Korporatës Energjetike të Kosovës, aktivitetet e Bashkësisë Islame të Kosovës në Komunën e Fushë-Kosovës, objektet e saj aktuale dhe të reja, hapësirat për çerdhe të fëmijëve. Pyetja tjetër ka të bëjë me rregullimin e trafikut, lirim të tij, sepse tani e kemi një kaos të madh. Unë kërkoj që para miratimit të Hartës Zonale të Komunës të sqarohen këto punë, në mënyrë që të mos na ikë diçka.

Ismaili Baftiari - përfaqësues i Kompanisë INSI: Është bërë një ingjizim me fluturake i gjendjes në teren, janë marrë parasysh dokumentet ekzistuese komunale të planifikimit hapësinorë, ligjet, udhëzimet administrative të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+, Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023, ne e kemi marrë parasysh gjendjen në teren, kemi reflektuar duke u mbështetur edhe në kufizimet ligjore. U përmend këtu një deponi e metaleve, me Hartën Zonale të Komunës nuk mund të bëhen rrënim të objekteve ekzistuese, kjo deponi harmonizohet me kushtet e zonës, trajtohet si zonë jokonforme me zhvillimin, ku inkorporohen edhe kërkesat për zhvillimin e lokacioneve tjera aty, ajo trajtohet si zonë jokonforme e kufizuar. Zonat suburbane parashihen në tërë territorin e komunës, kjo është bërë edhe për zonat rurale, sepse ka qenë obligim ligjor, parcializimi i kufijëve të ndërtimit. Ju e dini se në qytet është ndërtuar kudo dhe ekziston një gjendje. Çështja e objekteve fetare do të trajtohet me numrin e banorëve, ku parashihet objektet me karakter shoqëror, do të kalkulohen nevojat e zonës për Xhami. Duhet të ketë edhe plan për menaxhimin e varrezave, andaj është menduar që të rihvillohet edhe Plani Zhvillimor Komunal. Trafiku Urban tani paraqet një shqetësim, ai duhet të zhvillohet në bazë të analizave në relacionet që ndërlidhin Prishtinën dhe Fushë-Kosovën, këto kërkesa do të trajtohen me 'Planin e mobilitetit', trafiku në mënyrë të detajizuar do të rregullohet me këtë plan, që do të jetë në përputhje me Hartën Zonale të Komunës.

Driton Ademi: Nomenklatura që përdoret duhet të jetë unike, e mbështetur në kornizën ligjore, brenda normave të kufizuara, këtu si standard i lejuar duhet të përdoret regjistrimi i popullsisë, por në rastin tonë janë marrë parasysh orët e amvisërive, por kjo paraqet një sfidë për vlerësim të drejtë. Pyes, sa janë marrë parasysh kërkesat e dalura nga debatet publike për Hartën Zonale të Komunës?. Është dashur të merret parasysh struktura e organizimit të komunës, arrijtjet e komunës. Po ashtu shtrirja e vendbanimeve joformale, ne i kemi dy vendbanime të tilla.

Ismaili Baftiari - përfaqësues i Kompanisë INSI: Ne i kemi zbatuar normat teknike në vëllimin e tyre standard, sistemi i zhvillimit ka qenë i shkapërderdhur, ka patur lloj lloj kufizimesh, vija anësore 15m², banorët në zona shkallë shkallë, kemi zbatuar rregullat e 'Inspait', 'Hailuksit', direktivat e Bashkimit Evropian, kemi patur sfida gjatë punës, sepse është punuar në një komunë me zhvillim në të kaluarën. Ne i kemi ikur numrit të banorëve të regjistrimit të vitit 2011, ku janë mbi 30.000 mijë banorë, kemi marrë parasysh fakte tjera relevante për të kaluar në kategorinë nga 50.000-100.000 mijë banorë, që paraqet një përparësi për zhvillimin e komunës. Kjo hartë nuk është paraparë në aspektin financiar në Kornizën Afatmesme Buxhetore më herët, nevojat për impiantet e ujërave të zeza, ndoshta kjo mund të bëhet përmes huazimit të kreative. Për hartën zonale janë marrë parasysh të dhënat për fusha të caktuara nga Plani Zhvillimor Komunal që është multisektorial, ku jepen të dhëna për urbanizmin, bujqësinë e të tjera. Kjo hartë zonale varësisht nga zbatimi i saj kur e arrin 40%, mund të rishikohet pas katër viteve, të plotësohet harta zonale me pëlqimin e nivelit qendror. Disa aspekte të vendbanimeve joformale janë trajtuar, ku infrastruktura teknike është e trajtuar brenda dokumentit, ku janë paraparë kushte dhe masa për trajtimin e tyre.

Naser Graiçevci: Sa janë etazhet në zonën urbane, cilët janë koeficientat e ndërtimit, koeficientët komplet për zonën e caktuar?.

Ismaili Baftiari - përfaqësues i Kompanisë INSI: Caktimi i etazheve është bërë, duke marrë numrin për bazë të banorëve mbi 50.000 mijë dhe koeficienti arrin maksimum deri në tre në nivelin e komunës, ndërsa parametrat tjerë e caktojnë koeficientin e ndërtimit për çdo zone veç e veç, duke marrë parasysh edhe distancat anësore ndërmjet objekteve kolektive të banimit. Brengë për ne kanë qenë në raste të caktuar kushtet në nivel të zonës. Është bërë zonimi për ndërtime në zonën urbane, por edhe atë rurale. Baza për ndërtim është tre, por me bonuse të banimit mund të shkon deri në pesë, duke patur parasysh hapësirat publike.

Naser Graiçevci: Në bazë të parametrave të caktuar në hartën zonale duhet të dihen qartë koeficientët e ndërtimit. Po ashtu ka çështje që nuk janë paraparë saktë, as me Planin Zhvillimor Komunal, kanë ndodhur edhe shumë ndryshime në teren.

Ismaili Baftiari - përfaqësues i Kompanisë INSI: Caktimi i trasesë së autostradës është bërë pa konsultim me komunën, janë vendosur largpërçuesit e ri të tensionit të lartë, nuk është trajtuar as fizibiliteti për modernizimin e Hekurudhës.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne kemi patur nevojë për plane rregullative të hollësishme. Me Hartën Zonale të Komunës caktohen koeficientët e ndërtimit për zonën urbane në qytetin e Fushë-Kosovës, por edhe për zona rurale, ku ka kufizime për ndërtime në të ardhmen.

Durim Hajra: Ky dokument hapësinorë e përkufizon mënyrën e ndërtimit në të ardhmen, pyes a mund të marrë komuna bonuse të banimit në mënyrë të të përkrahët banimi i përballueshëm për qytetarët e komunës, duke e siguruar mirëqenien e tyre.

Ismaili Baftiari - përfaqësues i Kompanisë INSI: Qytetarët do t'i dinë bonueset e banimit për zona të caktuara, do të dihen zonat e zhvillimit ekonomik, objektet duhet të renditen në mënyrë harmonike, të kenë kufizime vetëm për funksionalitetin e tyre me planet e hollësishme.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për miratim dokumentin strategjik 'Propozimin për miratimin e Projekt-Hartës Zonale për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e miratoi 'Propozimin e Projekt-Hartës Zonale për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028' dhe mori:

V E N D I M

Për miratimin e 'Hartës Zonale për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028, me pjesën tekstuale dhe pjesën hartografike'

Pika e pestë (5) - Shqyrtimi i kërkesës për shfuqizimin e vendimit Nr. 151, të datës 30.07.2019 sipas shkresës 020-860/6, të datës 16.10.2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim kërkesën për shfuqizimin e vendimit Nr. 151, të datës 30.07.2019, sipas shkresës 020-860/6, të datës 16.10.2019, të cilin e kemi marrë në muajin korrik për zbatim të përkohshëm deri në miratimin e Hartës Zonale të Komunës. Hap diskutimin.

Migjen Kolshi: Për këtë pikë të rendit të ditës lidhur me shfuqizimin e vendimit 151, të datës 30.07.2019, ne kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar, kur ju e keni shtyerë shfuqizimin e këtij vendimi dhe keni bërë shkelje të ligjit. Shkresa për shfuqizim ka ardhur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në muajin e dhjetë të vitit të kaluar, tani jemi katër muaj pas, njësoi jeni duke bërë edhe me shkollën që keni planifikuar ta ndërtoni në pronat e Kompanisë ‘Al Trade’, me kompensim në ndërtime në objektet e saj. Unë kam paralajmëruar se me vendimin e shfuqizuar po kryhen ndërtime në teren, madje kjo është vazhduar edhe për një muaj nga mbledhja e kaluar, kjo nuk është mirë, sepse ka shkelje ligjore.

Durim Hajra: Qëndrimi ynë lidhur me këtë vendim dihet, ne kemi kërkuar që kjo çështje të trajtohet në Gjykatën Themelore të Prishtinës, sepse kanë kaluar tridhjetë ditë, këtë punë e rregullon ligji. E nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, këtu kemi të bëjmë me shkelje të ligjit, lejet e lëshuara sipas këtij vendimi duhet të pezullohen. Ne këtu nuk kemi asgjë personale me askënd, duhet të veprojmë ngjajshëm për arsye parimore, sepse ju keni zgjedhur që të veproini në kundërshtim me ligjin.

Mehdi Lahu: Kjo pikë është trajtuar në kundërshtim me dispozitat ligjore nga Kuvendi i Komunës, ne e kemi kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë për shfuqizimin e vendimit dhe ku shfuqizim nuk është bërë deri tani. Ne si opozitë kemi qenë dakort që ku vendim për zbatim të përkohshëm të miratohet, por meqë është në kundërshtim me ligjin është dashur të shfuqizohet me kohë, ndërsa këtu janë lëshura leje të ndërtimit.

Driton Ademi: Këtu mënyra e diskutimit duhet të jetë konceptuale jo personale, nuk kemi nevojë të japim vlerësime të caktuara. Rëndësinë parimore duhet ta kemi parasysh i nderuari z. Nënkryetari i Komunës, duhet t’i hapëni sytë, vetëm shfuqizimi nuk mjafton. Pika të paligjshme nuk duhet të dorëzohen për shqyrtim në Kuvendin e Komunës, në mënyrë që të mos kemi vlerësime të tilla.

Nënkryetari i Komunës: Ne këtë vendim e kemi marrë për zbatim të përkohshëm, meqë miratimi i Hartës Zonale të Komunës nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk po kryhet, tani e kemi të miratuar Hartën Zonale të Komunës pas një vonese të theksuar kohore pa fajin tonë. Në këtë vendim janë të gjitha normat teknike të ndërtimit që parashihen me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2017, këto norma të ndërtimit janë zbatuar, ne duhet të jemi në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve, me këtë vendim ne kemi dashur të jemi transparentë.

Aida Alimi: Kjo mënyrë e trajtimit në Kuvendin e Komunës nuk është e pranueshme, ky vendim është dashur të shfuqizohet menjëherë pas kthimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Nënkryetari i Komunës: Si akt ky vendim është thënë se vlen vetëm deri në miratimin e Hartës Zonale të Komunës, realisht vendimi është i shfuqizuar.

Naser Graiçevci: Ky shfuqizim ka hapur debat, vendimi është marrë në muajin korrik dhe ka qenë i favorshëm për bizneset, por meqë është trajtuar në kundërshtim me ligjin para tre muajëve është dashur të shfuqizohet, e jo të shtyhet kërkesa për shfuqizim.

Nënkryetari i Komunës: Problemi është se kemi patur vonesa që dihen në lidhje me Hartën Zonale të Komunës, secila punë është bërë në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2017 për normat teknike të ndërtimit.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ‘Shfuqizimin e vendimit Nr. 151, të datës 30.07.2019 sipas shkresës 020-860/6, të datës 16.10.2019’.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Shfuqizimin e vendimit Nr. 151, të datës 30.07.2019 sipas shkresës 020-860/6, të datës 16.10.2019' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e shfuqizimit të vendimit Nr. 151, të datës 30.07.2019 sipas shkresës 020-860/6, të datës 16.10.2019'.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetjake për vitin 2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetjake të grumbulluara përtej planifikimit për vitin 2019', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Përsëhendes të pranishmit në mbledhje. Në vitin 2019 planifikimi buxhetor për grumbullimin e të hyrave vetjake ka qenë në shumë të mjeteve financiare prej 2,400,000.00€, në muajin tetor të vitit të kaluar e kemi miratuar një rritje prej 550,000.00€, por ajo është tejkaluar deri më datën 31.12.2019 edhe për 370,000.00€, shpërndarjen e këtyre mjeteve financiare e keni në propozim të zbërthyer.

Driton Ademi: Rritja e të hyrave vetjake duhet të trajtohet në vitin paraprakë, kjo është çështje e kontabilitetit menaxherial dhe financiarë i cili duhet të përshtatet me planifikimin dhe politikat publike. Kjo rritje është tepër e madhe dhe tregon për një keqë planifikim të buxhetit. Këto mjete financiare duhet të jenë të qartësuara për shpenzim, por ju i përdorni për projektin e punësimit të Karitasit dhe çështje tjera në kategorinë e mallërave për shërbimeve. Për arsye se kontabiliteti dhe menaxhimi duhet të jenë të saktë në korelacion me shpenzimin e mjeteve financiare unë jam kundër.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Rritjen e të hyrave vetjake e kam sqaruar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, kufijtë për grumbullimin e të hyrave vetjake kanë qenë 2,400,000.00€, kjo është tejkaluar për 33.56%, mjetet financiare do të shpenzohen për projektin e Karitasit, për shërbime tjera, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë të kontraktuara, të gjitha i keni të zbërthyera në propozim.

Remzi Shala: Unë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kam theksuar, se kjo rritje në fund të vitit është e mirë dhe e ndihmon komunën në plotësimin e shumë nevojave bazike, pagat jubilarë në arsim janë duke u paguar parçialisht, unë dua të ju njoftoj se kjo ju takon dhe do të kërkohet edhe nga punëtorët shëndetësorë.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Lidhur me këtë çështje është vepruar në mënyra të ndryshme nga Komunitat e Kosovës, nuk ka një veprim unik, punëtorët arsimorë disa paga të tyre, i kanë realizuar edhe përmes përmbaruesit privat dhe me procedura gjyqësore. Kjo e drejtë ju takon të gjithëve, edhe punëtorëve të Shërbimit Civil.

Durim Hajra: U sqarua nga Drejtori për Financa dhe Buxhet, por këto dy pika dallojnë në substancë, rritja e të hyrave vetjake është e madhe dhe kjo tregon për një planifikim jo të mirë, të

buxhetit komunal, andaj ne jemi kundër kësaj mënyre të zhvillimit të projeksioneve buxhetore dhe shpenzimit të buxhetit kështu.

Driton Ademi: Ne e dimë se mjetet financiare të grumbulluara në fund të vitit nuk mund të shpenzohen, por ne e kemi patur edhe një rritje të buxhetit në muajin tetor, edhe një tani që tregon se kemi një keqë-planifikim të buxhetit. Për afarizëm të mirë duhen para, por edhe një planifikim i drejtë i buxhetit, shpërndarje e drejtë e realizimit të projekteve publike investive.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetjake për vitin 2019'.

U votua me: dymbëdhjetë vota 'për', dy 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetjake për vitin 2019' dhe mori:

V E N D I M

Për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2019, në shumën prej 370,549.56€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike të mallrave e shërbimeve, subvencioneve e transfereve dhe investime kapitale.

Pika e shtatë (7) - Propozim për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetjake të vitit 2019, për shpenzim në vitin 2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetjake të vitit 2019, për shpenzim në vitin 2020', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Këtë vitë për bartje e kemi shumën e mjeteve financiare prej 2,549,524.31€. Në krahasim me vitin fiskal 2018 lidhur me investime kapitale qëndrojmë më mirë në vitin 2019, kemi arritur që të shpenzojmë 66% të buxhetit të planifikuar për këtë kategori buxhetore me një angazhim të shtuar, kurse në vitin 2018 kjo shumë ka qenë 61%. Nga rritja e të hyrave vetjake janë gjithsej 849,000.00€ që nuk mund të procedohen për shpenzim, mjete financiare të kontraktuara janë gjithsej 797,000.00€, atëherë mbesin me pak se një milion euro.

Durim Hajra: Bartja e buxhetit në shumën e tillë të mjeteve financiare prej 2,549,524.31€ është një shumë e madhe, e cila tregon jo efikasitetin në qeverisje dhe manaxhim të buxhetit. Ju duhet t'i pyetni qytetarët, se a mjaftojnë projektet e realizuar, kur ka shumë kërkesa të pa realizuara të qytetarëve, kur shuma e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara ka shkuar gjithmonë duke u rritur dhe tani ka arritur këtë shumë që është shqetësuese dhe jo e shëndetëshme për ekonominë.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Këtë vitë është ulur bartja e mjeteve financiare, unë e sqarova arsyen pse është kjo shumë e mjeteve financiare që duhet të bartet për shpenzim. Me azhuritetin e Drejtorive të Komunës kemi arritur të realizojmë deri në 66% të buxhetit për projekte kapitale, standardi i caktuar nga Banka Botërore është 75%.

Migjen Kolshi: Kjo bartje kaq e madhe bëhet në vazhdimësi me synimin që të përdoret në vitin 2021, që është vit zgjedhor, kjo shumë pritet të rritet në tre milion euro. Shpërndahen subvencione, realizohen projekte, nga ju thuhet se bartja e mjeteve financiare është e ligjshme, por sa është e moralshme të bëhet në këtë mënyrë në funksion të marrjes së votave nga qytetarët e komunës.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Shfrytëzimi i buxhetit në vitin zgjedhor nga komuna jonë siç po theksoni ju është i pa saktë, nuk qëndron, kjo është e faktuar edhe me raportet financiare vjetore dhe bartjet e mjeteve financiare të pa shpenzuara.

Nënkryetari i Komunës: Ne punët publike nuk i kryejmë në vitin zgjedhor, por në tre vitet e para dhe qytetarët këtë e dinë dhe janë duke e vlerësuar drejtë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetjake të vitit 2019, për shpenzim në vitin 2020'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', katër 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetjake të vitit 2019, për shpenzim në vitin 2020' dhe mori:


V E N D I M

1. Lejohet bartja e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2018 dhe 2019, në vitin fiskal 2020 në shumë të përgjithshme prej 2,549,524.31€, sipas propozimit me dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 108, të datës 21.01.2020.
2. Bartja e mjeteve financiare nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara është për kategoritë ekonomike të shpenzimeve si vijon:
 - 2.1 Për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 52,000.00€;
 - 2.2 Për kategorinë ekonomike mallra e shërbime shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 249,900.63€;
 - 2.3 Për kategorinë ekonomike shpenzime për komunal shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 42,652.46€;
 - 2.4 Për kategorinë ekonomike subvencione shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 134,854.42€;
 - 2.5 Për kategorinë ekonomike investime kapitale shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 2,070,116.80€.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 12:50 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

